



FSHV
FEDERATA SHQIPTARE
E VOLEJBOLLIT

FEDERATA SHQIPTARE E VOLEJBOLLIT

Statuti
Federata Shqiptare e
Volejbollit

2025

Tabela Përmbajtjes:

Hyrje	4
Kreu I Parime të Përgjithshme	
Neni 1 Emri, forma dhe adresa	5
Neni 2 Logoja, flamuri, stema dhe vula	6
Neni 3 Qëllimi, fusha e veprimtarisë dhe objektivat	6
Kreu II Anëtarësia në FSHV	
Neni 4 Anëtarësimi	8
Neni 5 Të drejtat dhe detyrat e anëtarëve	9
Neni 6 Pezullimi, përjashtimi dhe dorëheqja e anëtarit	10
Kreu III Organizimi	
Neni 7 Organet e FSHV	10
Neni 8 Asambleja e Përgjithshme	11
Neni 9 Kompetencat e Asamblese së Përgjithshme	11
Neni 10 Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme	12
Neni 11 Përfaqësimi i anëtarëve në Asamblenë e Përgjithshme	13
Neni 12 Asambleja e Përgjithshme e Jashtëzakonshme	14
Neni 13 Asambleja e Përgjithshme Statutore	14
Neni 14 Zgjedhjet	15
Neni 15 Bordi Drejtues	16
Neni 16 Detyrat e Presidentit	19
Neni 17 Detyrat e Zv/Presidentit	19
Neni 18 Sekretar i Përgjithshëm	19
Kreu IV Financa	
Neni 19 Periudha financiare	20
Neni 20 Burimet financiare, sponsorizimet dhe reklamimet	20
Kreu V Sportisti, Kategoria e Sportistëve, Trajneri	
Neni 21 Sportisti	21
Neni 22 Kategoritë e sportistëve	22
Neni 23 Statusi i sportistit të nivelit të lartë	22
Neni 24 Trajneri	23
Neni 25 Detyrimet e sportistit dhe trajnerit	23
Kreu VI Infrastruktura Sportive	
Neni 26 Ndërtimi dhe përdorimi i objekteve sportive	23
Kreu VII Drejtësia Sportive	
Neni 27 Shqyrtimi administrativ	24
Neni 28 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve	24
Kreu VIII Antidoping, Kontrolli mjekësor në Sport dhe Sigurimi shëndetësor i sportistëve	
Neni 29 Përdorimi i substancave dhe metodave doping	25
Neni 30 Dispozita të veçanta në lidhje me doping	25
Neni 31 Kontrolli mjekësor në sport	26

Neni 32 Sigurimi shëndetësor i sportistëve	26
Kreu IX Parandalimi i dhunës në Sport	
Neni 33 Ndalimi i provokimeve dhe i sjelljeve të palejuara	27
Neni 34 Sendet e palejuara në objektet dhe mjediset sportive	28
Neni 35 Ruajtja e rendit dhe sigurisë publike	28
Neni 36 Roli i oficerit të sigurisë në veprimtarit ndërkombëtare	29
Kreu X Dispozitat përfundimtare dhe të fundit	
Neni 37 Dispozitat e fundit	30
Neni 38 Hyrja në fuqi	30

HYRJE

Statuti i Federata Shqiptare e Volejbollit është dokumenti themelor në të cilin bazohet administrimi i sportit të Volejbollit. Ky statut synon të jetë specifik i mjaftueshëm për të arritur harmonizimin e plotë në çështjeve ku kërkohet uniformiteti.

Federata Shqiptare e Volejbollit është person juridik, e tipit shoqatë jofitimprurese, e regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë sipas Vendimit Numër 835, të datës 24.11.2003.

Ky Statut është miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Federatës Shqiptare të Volejbollit në mbledhjen e datës **19.09.2025**.

KREU I

PARIME TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Emri, forma dhe adresa

1. Federata Shqiptare e Volejbollit përfaqëson bashkimin vullnetar të personave juridik, shoqatave sportive, klubeve sportive dhe shoqërive sportive të sportit të Volejbollit në Republikën e Shqipërisë.
2. Federata Shqiptare e Volejbollit vepron në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 79/2017, datë 27.04.2017 “Për Sportin”, i ndryshuar, ligjin nr.7850, datë 29.7.1994 “Kodin Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat Jofitimprurëse”, i ndryshuar, si dhe akte të tjera ligjore dhe nënligjore që rregullojnë këto aktivitete dhe që janë në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
3. Federata Shqiptare e Volejbollit do të përdor shkurtimin zyrtar **FSHV**.
4. Federata Shqiptare e Volejbollit, është anëtare e Federatave Ndërkombëtare si, Asosacioni i Federatave Ballkanike të Volejbollit (BVA), Konfederata Evropiane e Volejbollit (CEV), Federata Ndërkombëtare e Volejbollit (FIVB), respekton Statutin dhe rregulloret, direktivat dhe vendimet e tyre dhe siguron respektimin e tyre nga të gjithë anëtarët e saj.
5. Të ardhurat që krijohen nga burime të ndryshme ligjore ri investohen 100% për zhvillimin e aktivitetit të FSHV dhe përdoren për të mbështetur qëllimet jofitimprurëse të organizatës në funksion të realizimit të objektivave të saj.
6. Organizata mund të angazhohet në aktivitete ekonomike me qëllim të mbështetjes së aktiviteteve të saja jofitimprurëse, në pajtim me ligjin nr. 8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat Jofitimprurëse”, i ndryshuar, me kusht që të ardhurat e realizuara nëpërmjet të aktiviteteve ekonomike të shfrytëzohen ekskluzivisht për të arritur qëllimet e theksuara në këtë statut.
7. FSHV e ka selinë e saj qendrore në adresën;
Rr. Liman Kaba, Kompleksi Olimpik, Tiranë, Shqipëri.
8. FSHV është themeluar me afat të papërcaktuar.

Neni 2

Logoja, flamuri, stema dhe vula

1. Logoja, flamuri, stema, dhe vula janë simbolet e FSHV
 - a. Logoja është e përbërë nga ngjyra e kuqe që simbolizon vijat karakteristike të topit të volejbollit, si dhe ngjyra e zezë merr formën e shqiponjës së stilizuar.
 - b. Flamuri ka ngjyrë të bardhe, në qendër të të cilit gjendet logo e FSHV me përmasa 120cm x 80cm. Logoja e vendosur në mënyrë të barazlartuar, në hapësirën me ngjyrë të bardhë..
 - c. Stema përbëhet nga inicialet "FSHV",. Poshtë tyre me shkronja ku inicialet janë shkronja të mëdha si me poshtë: **Federata Shqiptare Volejbollit**
 - d. Vula ka në qendër logon e Federatës (neni 2). Në pjesën sipër shkruhet me shkronja kapitale në formë rrethore Republika e Shqipërisë dhe poshtë saj me shkronja kapitale po në formë rrethore Federata Shqiptare e Volejbollit. Në qendër është vendosur Logo e FSHV.

Neni 3

Qëllimi, fusha e veprimtarisë dhe objektivat

1. Qëllimi i FSHV është të promovojë dhe zhvillojë sportin e volejbollit në Republikën e Shqipërisë, si Sport Olimpik dhe Para-Olimpik. Të sigurojë një qeverisje efektive, të ruajë pavarësinë dhe autonominë e saj në administrimin e sportit të volejbollit në Shoqatat, Klubet dhe Shoqëritë sportive, anëtare të saj.
2. FSHV zhvillon dhe promovon sportin e volejbollit në territorin e Republikës së Shqipërisë në përputhje me rregullat dhe KODET e federatave ndërkombëtare respektive, Neni 1, pika 4 (BVA, CEV, FIVB). Ajo është një organizatë jofitimprurëse që përfaqëson bashkimin vullnetar të shoqatave sportive, klubeve sportive dhe shoqërive sportive shqiptare të cilat praktikojnë sportin e VOLEJBOLLIT
3. FSHV, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, ka këto objektiva:
 - a. Të zhvillojë, promovojë, kontrollojë dhe rregullojë aktivitetin sportiv tek grupmoshat e gjinitë në nivel kombëtar si dhe përfaqësimin në nivel ndërkombëtar, duke krijuar kushtet optimale për ushtrimin e volejbollit. Aktivitetet sportive

- përcaktohen në kalendarët respektive, kufijtë e moshave përcaktohen dhe disjplinohen në Rregulloret e FSHV në përputhje me Rregulloret e organizatave ndërkombëtarë ku ajo aderohet.
- b. Të ndihmojë në rritjen dhe zhvillimin e marrëdhënieve profesionale midis anëtarëve të FSHV, si dhe të mbrojë të drejtat e anëtarëve të saj.
 - c. Të kujdeset për zgjidhjen e problemeve tekniko-organizative, sportive, duke u mbështetur në Statut dhe Rregulloret e saj, Legjislacioni në Fuqi, si dhe aktet ligjore ndërkombëtare të veprimtarive të sportit të voleybollit.
 - d. Të marrë masa për ndalimin e diskriminimit në veprimtaritë sportive për shkaqe, si bindjet politike, fetare, raca, etnia, gjuha, gjinia, orientimi seksual, gjendja ekonomike dhe shoqërore.
 - e. Të përdorë eksperiencën dhe ekspertet e saj për të ndihmuar në rritjen dhe zhvillimin e marrëdhënieve miqësore midis anëtarëve të FSHV, duke inkurajuar frymën e tolerancës, të mirëkuptimit dhe lojës së drejtë (Fair Play) në të gjitha nivelet e aktiviteteve të saj.
 - f. Të organizojë kampionatin kombëtar dhe të shpallë “Kampionin Kombëtar” në sportin e voleybollit dhe disiplinave të tjera të saj (voleybolli plazhit, voleybolli dëborës, para voleybolli etj).
 - g. Të organizojë Kupën e Shqipërisë dhe të shpallë “Fituesin e Kupës së Shqipërisë” në sportin e voleybollit dhe disiplinave të tjera (neni 3,pika f).
 - h. Të organizojë, administrojë dhe kontrollojë disiplinën në sportin e voleybollit dhe derivatëve të saj në Republikën e Shqipërisë (neni 3,pika f).
 - i. Të mbrojë interesat e përbashkëta të shoqatave, klubeve të FSHV dhe të anëtarëve të saj.
 - j. Të aderojë në Komitetin Olimpik Kombëtar Shqiptar dhe atij Para-Olimpik.
 - k. Të përfaqësojë Republikën e Shqipërisë në Federatat ndërkombëtare përkatëse si (BVA, CEV, FIVB) etj.
 - l. Të organizojë ekipet kombëtare të të gjitha kategorive dhe të marrë pjesë në veprimtaritë sportive ndërkombëtare ose të autorizojë pjesëmarrjen e anëtarëve të saj në këto veprimtari.
 - m. Të organizojë në Republikën e Shqipërisë veprimtari sportive ndërkombëtare me miratimin e Ministrisë Përgjegjëse për Sportin dhe të japë leje për organizimin e tyre nga anëtarët e saj.
 - n. Të pajisë me Licencë sportistët, trajnerët dhe gjyqtarë në sportin e voleybollit.
 - o. Të drejtojë, të kujdeset dhe të kualifikojë të gjithë trajnerët dhe gjyqtarët, kombëtarë e ndërkombëtarë që aderojnë në FSHV.
 - p. Të koordinojë dhe jap pëlqimin për kryerjen e veprimtarive dhe garave sportive për anëtarët e saj.

- q. Të autorizojë përdorimin e simboleve të federatës nga anëtarët e saj përmes parashikimeve në Rregulloren e Brendshme të FSHV.
- r. Të mbështetëse pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuar në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare në disiplinen e para-volej.

KREU II

ANËTARËSIA NË FSHV

Neni 4

Anëtarësimi

1. Anëtarët e FSHV krijohen në një nga format ligjore të parashikuara në Ligjin për Sportin në Republikën e Shqipërisë. Anëtarët e FSHV mund të jenë persona juridikë, persona fizikë, klube sportive, shoqata sportive apo shoqëri sportive, të cilat paraqesin dokumentet themeluese të tyre si dhe dokumentet e tjerë plotësues të përcaktuar nga FSHV në rregulloret e saj.
2. Pas regjistrimit në gjykatë si person juridik, klubi sportiv, shoqata sportive ose shoqëria sportive, mund të kërkojnë të drejtën e anëtarësisë pranë FSHV.
3. Çdo kërkesë për t'u anëtarësuar në FSHV duhet të depozitohet me shkrim së bashku me dokumentet e nevojshëm të përcaktuar në rregulloren e saj.
4. Procedura për marrjen e të drejtës së anëtarit të FSHV si dhe kriteret për të fituar këtë të drejtë përcaktohen në Rregulloren e Brendshme e cila miratohet nga Asambleja.
5. Bordi drejtues pasi shqyrton dokumentacionin sipas Rregullores së Brendshme të FSHV i propozon Asamblesë së Përgjithshme të radhës, kandidaturën si Anëtar Provizor deri në Asamblenë e Përgjithshme pasardhëse.
6. Asambleja e Përgjithshme e FSHV vendos mbi anëtarësinë e një anëtari, kur kërkesa është në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e Brendshme të FSHV.
7. Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme për mos aprovimin ose përjashtimin e një anëtari duhet të jetë i arsyetuar konform rregullores së funksionimit të FSHV, kundër këtij vendimi për anëtarësim mund të paraqitet si ankim me shkrim sipas procedurës së përcaktuar pranë Këshillit të Arbitrazhit Sportiv (KAS).
8. Për t'u anëtarësuar në FSHV, secili i interesuar duhet të pranojë Statutin dhe Rregulloret e FSHV dhe të angazhohet për përmbushjen e qëllimeve të organizatës.
9. Anëtarët e regjistruar të FSHV janë të detyruar të kontribuojnë për FSHV nëpërmjet pagimit të kuotizacioneve të përcaktuara nga Asambleja e Përgjithshme.
10. Selia e një anëtari të FSHV duhet të jetë në territorin shqiptar.
11. Anëtarët e FSHV kanë të drejtë të marrin dijeni për të gjithë vendimet dhe veprimtaritë sportive të FSHV. Këto njoftime do të realizohen nëpërmjet dërgimit

të njoftimit nga organi i FSHV i cili ka marrë vendimin (postë, e-mail, faqes zyrtare informuese të federatës, etj).

12. Të gjithë anëtarët e FSHV janë të barabartë para këtij Statuti dhe Rregulloreve të FSHV.

Neni 5

Të drejtat dhe detyrat e anëtarëve

1. Anëtari i FSHV ka të drejtë:
 - a. Të pajiset me Karte ose Certifikatë anëtarësimi;
 - b. Të pajiset me Statutin dhe Rregulloret e FSHV;
 - c. Të informohet mbi veprimtarinë e FSHV sipas legjislacionit shqiptar në fuqi dhe Rregulloreve të saj ;
 - d. Të pajiset falas me botimet e ndryshme që mund të bëjë FSHV;
 - e. Të marrin pjesë në aktivitete, kombëtare e ndërkombëtare dhe ato miqësore që organizon FSHV .
 - f. Të njihet më parë me programin e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme dhe dokumentacionin përkatës dhe të thirret në takim në kohën e përcaktuar;
 - g. Të përfaqësohet me të drejtë vote në Asamblenë e Përgjithshme me një përfaqësues të zgjedhur prej tij kur është anëtarë me të drejta të plota në Asamblenë e FSHV.
2. Anëtari provizor pajiset me Kartën e Anëtarit Provizor dhe përfiton të drejtat e parashikuara në germa b, c, d, e, të pikës 1 të këtij neni.
3. Anëtari i FSHV ka këto detyrime:
 - a. Të pranojë dhe të zbatojë Statutin, Rregulloret, vendimet dhe direktivat e FSHV dhe organizatave kombëtare dhe ndërkombëtare.
 - b. Të paguajë në kohë detyrimet financiare ndaj FSHV.
 - c. T'i komunikojë FSHV çdo ndryshim në Statutet dhe Rregulloret e anëtarit pranuar nga Gjykata shkallës së Parë si dhe listën e personave ose zyrtarëve me të drejtë firme për të hyrë në marrëveshje ligjore me palët e treta.
 - d. Të zgjedhë organet drejtuese, ekzekutive dhe nëse e gjykon të arsyeshme dhe organin e saj disiplinor.
 - e. Të njohë parimet e ndershmërisë, *fair play*-it, integritetit dhe sjelljes korrekte sportive.
 - f. Të njohë të gjitha detyrimet e tjera që dalin nga Statuti, rregulloret, vendimet dhe direktivat e FSHV.

- g. Të mos lejojë asnjë person anëtar të saj të cenoje apo denigroje imazhin dhe punën e FSHV. Të mos lejoj asnjë anëtar të saj të marrë pjesë në veprimtari të sportit të volejbollit të pa certifikuara nga FSHV.
- h. Anëtarët e FSHV duhet të integrojnë në Statutet e tyre detyrimet e lartpërmendura. Shkelja e detyrimeve të lartpërmendura nga ndonjë anëtar mund të sjellë sanksione të parashikuara në këtë Statut dhe Rregulloret e FSHV.

Neni 6

Pezullimi, përjashtimi dhe dorëheqja e anëtarit

1. Pezullimi apo përjashtimi i anëtarit bëhet me vendim të arsyetuar të Asamblesë së Përgjithshme. Vendimi i pezullimit përcakton edhe afatin e pezullimit.
2. Pezullimi i anëtarit të FSHV ndodh në rastin e konstatimit të shkeljeve të Statutit, Rregulloreve, vendimeve dhe direktivave të FSHV dhe organizmave ndërkombëtar (neni 1, pika 4).
3. Në raste urgjente Bordi Drejtues mund të japë pezullim provizor deri në Asamblenë e radhës e cila duhet të shprehet, për vendimin e Bordit Drejtues.
4. Statusi i anëtarit mbaron me dorëheqjen ose përjashtimin e anëtarit nga Asambleja e Përgjithshme.
5. Përjashtimi i anëtarit ndodh në rastet e shkeljes së Statutit, Rregulloreve të FSHV, të mospagimit të kuotizacionit vjetor, detyrimeve të prapambetura apo mospjesëmarrje në aktivitetet zyrtare kombëtare. Përjashtimi i anëtarit nuk e liron atë nga detyrimet e veta financiare të pa përmbushura kundrejt FSHV.
6. Dorëheqja e anëtarit bëhet me kërkesë me shkrim drejtuar Bordit Drejtues. Akti i pranimit të dorëheqjes aprovohet në mbledhjen e radhës të Bordit Drejtues. Pranimi i dorëheqjes nuk e liron anëtarin nga detyrimet e pa përmbushura kundrejt FSHV.

KREU III

ORGANIZIMI

Neni 7

Organet e FSHV

1. Organet e FSHV, janë :
 - a. Asambleja e Përgjithshme - është organi më i lartë vendimmarrës i FSHV;
 - b. Bordi Drejtues - është organi më i lartë ekzekutiv i FSHV;

- c. Presidenti-përfaqësuesi më i lartë i FSHV
 - d. Zv/Presidenti
 - e. Sekretariati i Përgjithshëm - është organi më i lartë administrativ.
2. Komisionet e Përhershme të FSHV, janë:
- a. Komisioni Teknik;
 - b. Komisioni i Disiplinës;
 - c. Komisioni Legal;
3. Komisionet e Përkohshme të FSHV, janë:
- a. Komisioni i Blerjeve;
 - b. Komisioni i Trajnëreve;
 - c. Komisioni Organizativ i Aktivitetit.
 - d. Komisioni Financiar

Neni 8

Asambleja e Përgjithshme

1. Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i FSHV dhe përfaqëson autoritetin më të lartë vendimmarres të saj.
2. Asambleja e Përgjithshme përbëhet nga tërësia e të gjithë anëtarëve të saj, të cilët përfaqësohen me 1 (një) votë.
3. Asambleja e Përgjithshme ka përgjegjësinë më të lartë për përcaktimin e fushës dhe gjithë veprimtarisë së FSHV.

Neni 9

Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme

1. Asambleja e Përgjithshme ka këto kompetenca:
 - a. Miraton buxhetin, raportet financiare dhe raportet e punës së FSHV;
 - b. Asambleja miraton kompaninë audituese të pavarur që ka eksperiencën dhe kualifikimin e nevojshëm për auditimin e llogarive financiare, sipas procedurave dhe përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;

- c. Përcakton numrin e plotë të anëtarëve me të drejte vote në Asamblenë e Përgjithshme;
 - d. Asambleja zgjedh Presidentin e Federatës, dhe anëtarët e Bordit Drejtues me votim të fshehtë;
 - e. Miraton pranimin a anëtarëve, pezullimin, përjashtimin apo dorëheqjen e një anëtari sipas parashikimit në këtë Statut;
 - f. Deklaron shkrirjen e Federatës dhe likuidimin e veprimeve të saj financiare;
 - g. Miraton Kalendarin e aktiviteteve të propozuara nga Bordi Drejtues;
2. Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme, të parashikuara në nenin 20 të ligjit nr 8788, datë 7.5.2001 “Për organizatat jofitimprurëse” nuk mund të delegohen në organet e tjera.

Neni 10

Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme

1. Asambleja e Përgjithshme e FSHV thirret nga Presidenti ose Bordi Drejtues.
 - a. Presidenti i FSHV ka detyrimin për thirrjen dhe organizimin e Asamblese së Përgjithshme, njoftimin me shkrim të të gjithë anëtarëve 30 dite përpara ditës së zhvillimit të saj.
 - b. Njoftimi për datën, orën dhe rendin e ditës do t’u shpërndahet të gjithë anëtarëve së paku 10 (dhjetë) ditë para ditës së mbajtjes së mbledhjes së Asamblesë.
2. Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme kur janë prezent më shumë se gjysma e anëtarëve që kanë të drejtë vote, me përjashtim të rastit kur është parashikuar zgjedhja e Presidentit.
 - a. Nëse shumica e thjeshtë nuk arrihet, një Asamble tjetër e Përgjithshme duhet të bëhet 30 (tridhjetë) ditë pas të parës, me të njëjtin rend dite.
3. Bordi Drejtues përcakton rendin e ditës i cili duhet të përmbajë të paktën:
 - a. Verifikimi i përbërjes së Asamblesë;
 - b. Raporti i Presidentit;
 - c. Miratimi i raportit të aktiviteteve;
 - d. Miratimi i raportit financiar;
 - e. Miratimi i veprimtarive financiare për vitin pasardhës;
 - f. Zgjedhjet për çdo vend vakant;
 - g. Shqyrtimi i propozimeve për amendamentet në Statut dhe Rregullore;
4. Njoftimi për rendin e ditës, raportet e aktiviteteve, buxheti, llogaritë dhe çdo dokument tjetër duhet t’u dërgohet anëtarëve 10 (dhjetë) ditë përpara datës së zhvillimit të saj.

5. Asambleja thirret në mbledhje të zakonshme jo më pak se 4 (katër) herë gjatë një mandati 4 (katër) vjeçar (çdo vit nga një herë), por ajo mund të mbledhet edhe në mbledhje të jashtëzakonshme kur thirret nga:
 - a. Presidenti i FSHV,
 - b. Kur kërkohet nga 2/3 e anëtarëve të Asamblesë me të drejte vote;
Kërkesa i drejtohet Presidentit të FSHV, i cili ka detyrimin për thirrjen dhe organizimin e mbledhjes, bazuar në nenin 10, pika 1/a .
 - c. Në mungesë të Presidentit është Bordi Drejtues që duhet të thërrasë Asamblenë bazuar në nenin 10, pika a.
6. Çdo anëtar ka të drejtë të propozojë përfshirjen në rendin e ditës të një çështjeje përmes një kërkesë e cila duhet ti paraqitet Bordit Drejtues të paktën 20 ditë përpara mbledhjes. Bordi Drejtues, shqyrton propozimin dhe në rast se e pranon atë duhet t'ja dërgojë anëtarëve 10 ditë përpara datës së mbledhjes së Asamblesë, rendin e ditës ku përfshihet kërkesa e anëtarit.
7. Në mbledhjet e Asamblesë marrin pjesë pa të drejtë vote, anëtarët e Bordit Drejtues, Sekretari i Përgjithshëm, përfaqësues të Ministrisë Përgjegjëse për Sportin apo të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar.
Bordi Drejtues mund të aprovojë listën me të ftuar nderi të aprovuar nga Asambleja e Përgjithshme . Të ftuarit janë pa të drejtë vote por mund t'ju jepet fjala pas lejes së dhënë nga Drejtuesi i Asamblesë.
8. Çdo vendim i marrë nga Asambleja e Përgjithshme mund të ndryshohet, shfuqizohet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.
9. Rendi i ditës mund të ndryshohet vetëm nga një shumicë që përbën 2/3 e votave të shumicës (50% +1) para fillimit të punimeve të Asamblesë.
10. Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme drejtohen nga Presidenti i FSHV, në mungesë të tij nga Zv/presidenti, kur edhe ai mungon, nga anëtari më i vjetër i Bordit Drejtues.

Neni 11

Përfaqësimi i anëtarëve në Asamblenë e Përgjithshme

1. Çdo anëtar i FSHV përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme me një përfaqësues, i zgjedhur në Asamblenë e Përgjithshme të shoqatës, klubit, apo shoqërisë sportive.
2. Çdo anëtar dërgon në FSHV, në rrugë zyrtare, dokumentacionin e përfaqësuesit të tij të zgjedhur. Dokumentacioni përmban autorizimin e anëtarit të aprovuar nga Bordi Drejtues me vulën e FSHV dhe firmosur e vulosur nga titullari i

Shoqates/klubit me emrin e përfaqësuesit të tij. Ky dokumentacion dërgohet pranë Sekretarit të Përgjithshëm, jo më vonë se 20 ditë përpara zhvillimit të mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të FSHV. Mosparaqitja në kohën e duhur e këtij dokumenti i heq të drejtën anëtarit për të marrë pjesë (me të drejtë vote), në këtë Asamble.

3. Ky përfaqësues ka të drejtën e votës në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme.
 - a. Kjo e drejtë vote nuk mund t'i delegohet një personi tjetër.
 - b. Votimi me prokurë nuk lejohet.
 - c. Në takimet e Asamblesë së Përgjithshme, përfaqësuesi i çdo anëtari apo shoqate duhet të disponojë një dokument ligjor identifikimi (kartë identiteti/pasaportë) dhe nuk duhet të jetë në kushtet e konfliktit të interesit apo të jete i penalizuar nga komisionet e FSHV.

Neni 12

Asambleja e Përgjithshme e Jashtëzakonshme

1. Presidenti mund të mbledhë Asamblenë e Jashtëzakonshme nëse e konsideron të domosdoshme.
2. Bordi Drejtues mund të mbledhi Asamblenë e Përgjithshme të Jashtëzakonshme pas kërkesës së 2/3 e anëtarëve të Asamblesë, kërkesë e cila duhet të drejtohet me shkrim firmosur prej anëtarëve me të drejtë vote.
3. Bordi Drejtues është i detyruar të mbledhë Asamblenë e Përgjithshme të Jashtëzakonshme jo më vonë se dy muaj pas marrjes së kërkesës.
4. Njoftimi për mbledhjen e Asamblesë së Jashtëzakonshme duhet të dërgohet 30 ditë para zhvillimit të saj.
5. Rendi i ditës të Asamblesë së Jashtëzakonshme vendoset nga Bordi Drejtues dhe përcaktohet nga kërkesa e ngritur nga anëtarët. Kur kjo Asamble nuk thirret nga Bordi Drejtues, anëtarët me të drejtë vote mund ta thërrasin Asamblenë vetë duke ngarkuar një Kryetar të përkohëshëm me një grup pune, rendi i ditës duhet të përmbajë pikat e vendosur prej tyre.
6. Rendi i ditës nuk mund të ndryshohet dhe duhet t'u dërgohet anëtarëve 10 ditë para zhvillimit të saj.

Neni 13

Asambleja e Përgjithshme Statutore

1. Presidenti i FSHV mund të thërrasi Asamblenë Statutore nëse e konsideron të domosdoshme .

2. Bordi Drejtues mund të thërrasi Asamblen Statuore nëse e konsideron të domosdoshme me 2/3 e votave të saj.
3. Njoftimi për mbledhjen e Asamblesë Statuore duhet të dërgohet 30 ditë para zhvillimit të saj.
4. Rendi i ditës të Asamblesë Statuore duhet të përmbajë:
 - Verifikimin e mbledhjes;
 - Diskutim dhe miratim Statuti;
5. Rendi i ditës nuk mund të ndryshohet dhe duhet t'u dërgohet anëtarëve 10 ditë para zhvillimit të saj.

Neni 14 **Zgjedhjet**

1. Zgjedhjet bëhen me votim të fshehtë ose me votim të hapur nëse kjo miratohet nga shumica e anëtarëve .
2. Zgjedhjet në FSHV janë periodike dhe zhvillohen çdo 4 (katër) vjet.
3. Presidenti dhe Anëtarët e Bordit Drejtues zgjidhen për një periudhë 4 (katër) vjeçare, me të drejtë rikandidimi .
4. Në të gjitha forumet drejtuese apo komisionet ndihmëse në FSHV, femrat duhet të jenë të përfaqësuara minimalisht në masën 10%.
5. Të drejtën për të kandiduar për postin e Presidentit e ka çdo njeri i propozuar minimalisht nga 30 % i anëtarëve të FSHV me të drejtë vote jo më vonë se 20 (njëzet) ditë përpara datës së Asamblesë.
6. Të drejtën për të propozuar anëtare për Bordin Drejtues e ka çdo anëtar i FSHV anëtar i Asamblesë me të drejtë vote.
7. Çdo kandidat për President apo Bord Drejtues ka të drejtën të zhvillojë aktivitete për paraqitjen e programit të tij.
8. Kandidati për President duhet të përmbushë këto kritere:
 - a. Të jetë shtetas shqiptar, me banim në Shqipëri 5 vjetët e fundit;
 - b. Të ketë moshë mbi 30 vjeç;
 - c. Të ketë arsim të lartë dhe kualifikime të vertëtuara pasuniversitare;
 - d. Të ketë certifikim të gjuhës angleze;
 - e. Të ketë figurë të pastër morale;
 - f. Të mos jetë i dënuar nga organet e drejtësisë shqiptare dhe të huaja;
 - g. Të mos jetë në kushtet e konfliktit të interesit me postin e Presidentit;
 - h. Të ketë kontribuar mundësisht në fushën e sportit si sportist, trajner, gjyqtar, apo donator financues.
9. Në raundin e parë, Presidenti ka nevojë për 2/3 e votave të vlefshme të të gjithë anëtarëve. Në rastet kur asnjë nga kandidatët nuk arrin këtë shumicë, bëhet një raund i dytë zgjedhjesh midis dy kandidatëve që kanë marrë më shumë vota në

raundin e parë. Në raundin e dytë, kandidati që merr më shumë vota zgjidhet President. Në rastet e votave të barabarta, votimi do të përsëritet, deri sa fitues të shpallet kandidati që merr më shumë vota se kandidati tjetër.

10. Kandidatë për anëtarë të Bordit Drejtues, përzgjidhen ata persona të cilët kanë minimalisht një propozim nga anëtarët e Asamblese me të drejte vote.
11. Emrat e kandidatëve, për President dhe Bord Drejtues duhet të dërgohen bashkë me CV e tyre nga anëtarët, në Sekretariatit e Përgjithshëm të FSHV sipas formulareve të aprovuar nga Bordi Drejtues jo me vone se 20 (dite) përpara datës së Asamblesë. Sekretariati i Përgjithshëm verifikon kandidaturat dhe ia paraqet rezultatet Bordit Drejtues për miratim. Lista e aprovuar e kandidatëve, të cilët plotësojnë kushtet, i paraqitet përfaqësuesve të anëtarëve së bashku me Rendin e Ditës së Asamblesë.
12. Kandidati për Anëtar të Bordit Drejtues duhet të përmbushë këto kritere:
 - a. Të jetë shtetas shqiptar, me banim në Shqipëri;
 - b. Të ketë arsim të lartë;
 - c. Të ketë njohuri nga një prej gjuhëve të huaja të Komunitetit Evropian;
 - d. Të ketë figurë të pastër morale;
 - e. Të mos jetë njëkohësisht anëtar i zgjedhur në forumet drejtuese në një federate tjetër;
 - f. Të mos jenë te dënuar nga organet e drejtësisë shqiptare dhe të huaja;
 - g. Të mos jenë te dënuar nga një federatë sportive për thyerje disipline, përdorim doping, abuzime financiare e të tjera, apo të ketë masë disiplinore në ngarkim nga FSHV.
 - h. Të mos ketë konflikt interesash me të qenit anëtar i Bordit Drejtues si përfaqësues klubesh/shoqatash, trajner, gjyqtare, sportist aktiv.
 - i. Të ketë ushtruar sportin e volejbollit ose te kete kontribute te tjera ne të ketë sport ose tituj akademik në fushën e sportit.
13. Mënyra e organizimit të zgjedhjeve, procedura e ndjekur, njoftimet, afatet, përcaktohen sipas Statutit të FSHV.
14. Një anëtar i FSHV nuk mund të propozojë më shumë se një kandidat për Anëtar të Bordit Drejtues.

Neni 15

Bordi Drejtues

1. Bordi Drejtues është organi drejtues ekzekutiv me i larte i FSHV.
2. Ai përbëhet nga 7 (shtate) anëtarë me këtë strukturë: Presidenti dhe 6 (gjashte) anëtarë.
3. Bordi Drejtues ka këto kompetenca:

- a. Menaxhon dhe drejton punët e FSHV në përputhje me Statutin dhe Rregulloret e saj, duke siguruar zbatimin e tyre;
 - b. Mbikqyr dhe kontrollon përmbushjen e vendimeve, rregulloreve, direktivave të miratuara prej saj;
 - c. Emëron dhe shkarkon Sekretarin e Përgjithshëm me propozim të Presidentit.
 - d. Zgjedh midis anëtarëve të tij Zv/presidentin ose Zv/presidentët;
 - e. Miraton Rregulloren Kodin e Etikës dhe rregullat për organin administrativ konforme ligjeve në fuqi,
 - f. Miraton titujt e nderit brenda juridiksionit të saj;
 - g. Përgatit dhe mban Asamblenë e Përgjithshme të zakonshme dhe të Jashtëzakonshme;
 - h. Rishikon pasqyrën e llogarive dhe harton projekt buxhetet;
 - i. Harton raportin për aktivitetet;
 - j. Lejon, organizon ose anulon aktivitetet zyrtare të nivelit kombëtar e ndërkombëtar të FSHV dhe anëtarëve të saj;
 - k. Përcakton, lejon ose anulon pjesëmarrjen e FSHV në aktivitetet zyrtare të nivelit ndërkombëtar;
 - l. Për shkelje të rënda të Statutit dhe rregulloreve të FSHV mund të japë pezullim provizor të anëtarëve deri në mbledhjen e Asamblesë së radhës;
 - m. Emëron, pezullon ose shkarkon anëtarët e Komisioneve të Përhershëm ose të Përkohshme të FSHV;
 - n. Harton Rregulloret dhe bën ndryshimet e nevojshme në çdo moment që e shikon të ndërhyje;
 - o. Harton e propozon në Asamblenë e Përgjithshme ndryshime statutores.
4. Rregullat e punës së anëtarëve të Bordit Drejtues përcaktohen në këtë statut, i cili aprovohet nga Asambleja e Përgjithshme me shumicë votash.
 5. Anëtarët e Bordit Drejtues mund të shkarkohen para përfundimit të mandatit për shkelje statutores, rregulloreve të FSHV dhe prishjes së imazhit të saj, me shumicë votash nga Asambleja e Përgjithshme.
 6. Në rast të përfundimit të parakohshëm të mandatit të anëtarit Bordit Drejtues, Asambleja e Përgjithshme duhet të zgjedhë anëtarin pasardhës me votim për të ushtruar funksionet për kohën e mbetur të mandatit.
 7. Vendimet në Bordin Drejtues merren me shumicë votash të anëtarëve:
 - a. Bordi Drejtues mbledhet jo më pak se 6 (gjashtë) herë në vit;
 - b. Mbledhjet e Bordit Drejtues nuk mbahen në publik;
 - c. Mbledhja drejtohet nga Presidenti në mungesë të tij nga Zv/presidenti;
 - d. Presidenti bën njoftimin për mbledhje 5 ditë përpara zhvillimit të mbledhjes;

- 1/3 e anëtarëve të Bordit Drejtues mund t'i kërkojnë Presidentit mbledhje jashtë radhe.
- Presidenti duhet të mbajë mbledhjen brenda 5 ditësh pas marrjes së kërkesës;
- e. Sekretari i Përgjithshëm merr pjesë në takimet e Bordit Drejtues, por pa të drejtë vote.
- f. Bordi Drejtues mund të ftojë palë të treta të marrin pjesë në mbledhje. Këto palë të treta nuk kanë të drejtë votimi dhe mund të shprehin opinionin e tyre vetëm me miratimin e Presidentit të FSHV.
- g. Bordi Drejtues fillon mbledhjet vetëm kur janë të pranishëm me shumë se gjysma e anëtarëve të tij. Vendimet merren me shumicë të thjeshtë të votave të anëtarëve prezent;
- h. Në rastin e votave të barabarta, Presidenti ka votë vendimtare;
- i. Kur anëtari i Bordit Drejtues mungon në më shumë se 3 (tre) mbledhjeve të Bordit Drejtues gjatë një viti, ai pezullohet nga Bordi Drejtues dhe shkarkohet nga Asambleja e rradhës.
- j. Në rast se një anëtar i Bordit Drejtues ka konflikt interesi me çështjen për të cilën debatohet ai përjashtohet nga debati dhe nuk merr pjesë në votim për këtë çështje;
- k. Vendimet e marra nga Bordi Drejtues hyjnë në fuqi menjëherë, përveç rasteve kur Bordi Drejtues vendos ndryshe. Këto vendime zbardhen dhe bëhen të njohura brenda 5 ditëve.
- l. Bordi Drejtues mund të vendosë t'i drejtohet për çfarëdo lloj çështje Asamblesë së Përgjithshme për marrje të një vendimi, me e-mail zyrtarë të shoqatave/Klubeve ose online nëpërmjet platformave digitale.
- m. Bordi Drejtues aprovon listat e ekipeve pjesëmarrëse, formulën e aktiviteteve, numrin e tyre, pjesëmarrjen e ekipeve kombëtare në aktivitete ndërkombëtare zyrtare e miqësore, vendin e fazën përgatitore të ekipeve kombëtare dhe listat e ekipeve kombëtare për aktivitetet ndërkombëtare.

Neni 16

Detyrat e Presidentit

1. Është përfaqësuesi ligjor i FSHV në arenën kombëtare dhe atë ndërkombëtare.
2. Presidenti lobon kudo që e shikon të arsyeshme për FSHV brenda dhe jashtë vendit për interesat e saj dhe të antarëve të FSHV.
3. Emëron dhe shkarkon trajneret e ekipive kombëtare.
4. Kërkon thirrjen e Asamblesë Përgjithshme të zakonshme dhe të jashtëzakonshme
5. Kërkon thirrjen e Bordit Drejtues .
6. Drejton Asamblenë e Përgjithshme.
7. Drejton mbledhjet e Bordit Drejtues.
8. Siguron zbatimin e vendimeve të Asamblesë.
9. Siguron nëpërmjet Sekretariatit të FSHV zbatimin e vendimeve të Bordit Drejtues.
10. Në rast se Presidenti jep dorëheqjen Bordi Drejtues cakton Zv/Presidentin në funksionin e Presidentit përkohësisht deri në mbledhjen e Asamblesë së Jashtëzakonshme e cila duhet thirrur brenda 60 diteve.

Neni 17

Detyrat e Zv/Presidenti

1. Të kryejë detyrat e përfaqësimit të Presidentit në ato raste kur ja delegon Presidenti.
2. Të drejtojë Asamblenë e Përgjithshme në rast kur Presidenti mungon.
3. Merr pjesë rregullisht në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme.
4. Drejton mbledhjen e Bordit Drejtues kur Presidenti mungon.
5. Të sigurojë zbatimin e vendimeve të Asamblesë dhe Bordit Drejtues në munges të Presidentit.

Neni 18

Sekretariati i Përgjithshëm

1. Sekretariati i Përgjithshëm drejtohet nga Sekretari i Përgjithshëm i cili emërohet nga Bordi Drejtues i FSHV me propozim të Presidentit.
2. Kandidati për Sekretar të Përgjithshëm duhet:
 - a. Të jetë shtetas shqiptar me banim në Shqipëri;
 - b. Të ketë arsim të lartë, dhe kualifikime të vërtetuara pasuniversitare;
 - c. Të ketë kualifikime të vërtetuara në menaxhimin e organizatave olimpike;
 - d. Të ketë njohuri të një gjuhë të BE ;
 - e. Të ketë figurë të pastër morale;
 - f. Të ketë moshën mbi 30 vjeç;
 - g. Të mos jetë i dënuar nga organet drejtësisë shqiptare dhe të huaja;
 - h. Të mos jetë njëkohësisht anëtar i zgjedhur në forumet drejtuese në një federatë tjetër;

- i. Të mos jetë i dënuar nga një federatë sportive për thyerje disipline, përdorim dopingu për abuzime financiare apo të ketë masë disiplinore në ngarkim nga FSHV.
 - j. Të mos ketë konflikt interesash me të qenit Sekretar i Përgjithshëm.
3. Struktura e Sekretarit të Përgjithshëm, të Sekretariatit të FSHV dhe funksionimi i tyre përcaktohen në rregulloren e hartuar nga Bordi Drejtues.

KREU IV

FINANCA

Neni 19

Periudha financiare

1. Periudha financiare për Federatën do të jetë viti financiar sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 20

Burimet financiare, sponsorizimet dhe reklamimet

1. Të ardhurat e FSHV sigurohen nga:
- a. Fonde të dhëna nga Buxheti i Shtetit, në formë transferte, të parashikuara në Buxhetin e Shtetit, si dhe burime të tjera të ligjshme. Mënyra e përdorimit të këtij fondi përcaktohet me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Financave dhe të Ministrit Përgjegjës për Sportin. Ministria Përgjegjëse për Sportin mbikëqyr dhe kontrollon administrimin e transfertës së Buxhetit të Shtetit në të gjitha organizatat sportive që kanë përfituar nga fondet publike;
 - b. Regjistrimet dhe kuotat vjetore të anëtarëve;
 - c. Të ardhurat e krijuara nga marketingu i të drejtave që gëzon FSHV;
 - d. Nga sponsorizimet, donacionet, dhurimet, financimet nga shteti, asetet e saj të dhëna me qira dhe burime të tjera të lejuara;
 - e. Nga liçensimi i trajnerëve, sportistëve, gjyqtarëve, specialistëve, mjekëve, etj;
 - f. Nga kuaotat e testime të ndryshme të trainerëve, sportistëve, sportiste amatore, gjyqtarëve, specialistëve, etj;
 - g. Nga kuotat e anëtarësimit në FSHV.

2. Klubet sportive ose sportistët, në përputhje me Rregulloret e FSHV kanë të drejtë të vendosin në uniformat që përdorin gjatë zhvillimit të veprimtarisë zyrtare sportive emrin e shoqërisë sponsorizuese, të shoqërisë sportive ose klubit sportiv në përputhje me kushtet e përcaktuara në kontratën e sponsorizimit ndërmjet klubit, FSHV dhe sponsorizuesit. Kontratat hartohet në përputhje me Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë dhe sipas standardeve dhe rregulloreve ndërkombëtare. Madhësia dhe forma e mbishkrimeve duhet të jenë në përputhje me normat dhe rregulloret e FSHV dhe me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

3. Organizatorët e veprimtarive sportive gëzojnë të drejtën të përdorin sipërfaqet e dukshme të mjediseve sportive, ku ata zhvillojnë veprimtarinë sportive, për qëllime reklamimi ose sponsorizimi me personat fizikë apo juridikë, vendas apo të huaj, në bazë të marrëveshjeve kontraktuese të lidhura me to.

KREU V

SPORTISTI, KATEGORITË E SPORTISTËVE, TRAJNERI

Neni 21

Sportisti

1. Sportisti ka të drejtë ta zgjedhë vetë shoqatën sportive, klubin sportiv, shoqërinë sportive, ku dëshiron të aktivizohet dhe ta ndryshojë atë në përputhje me statutet e tyre dhe rregulloret e përcaktuara nga FSHV.
2. Pjesëmarrja e sportistit në këto organizata bëhet sipas procedurave të përcaktuara në Statut dhe në legjislacionin që rregullon marrëdhëniet e tyre. Sportisti është i detyruar të zbatojë të gjitha detyrimet që rrjedhin nga akt-marrveshjet sipas legjislacionit në fuqi.
3. Transferimi i sportistit nga një klub sportiv në një tjetër, brenda ose jashtë vendit, bëhet në përputhje me rregulloret e veprimtarive sportive të miratuara nga FSHV dhe nga Federatat Ndërkombëtare.

Neni 22

Kategoritë e sportistëve

1. Sportistët ndahen në amatorë, profesionistë dhe të nivelit të lartë sipas kushteve të përcaktuara në këtë Statut.
2. Sportistë amatorë janë ata sportistë, që praktikojnë sportin e volejbollit dhe nuk kanë ndonjë akt marrveshje të lidhur me shoqatën sportive, klubin sportiv, apo shoqërinë sportive ku ata aktivizohen.
3. Sportistët profesionistë janë ata persona që praktikojnë sistematikisht sportin e volejbollit si një profesion dhe fitojnë ose shpërblehen me të ardhura në bazë të nënshkrimit të akt marrveshjeve me shoqatën sportive, klubin sportiv, apo shoqërinë sportive në të cilat ata aktivizohen.

Neni 23

Statusi i sportistit të nivelit të lartë

1. Sportistët të cilët përfitojnë statusin e nivelit të lartë në përputhje me Ligjin për Sportin, klasifikohen sipas rezultateve të larta sportive në veprimtaritë ndërkombëtare zyrtare:
 - a. “Vendi i parë deri në të tetin në Lojërat Olimpike”;
 - b. “Vendi i parë deri në të tetin në kampionate botërore”;
 - c. “Vendi i parë deri në të tetin në kampionate europiane”;
 - d. “Vendi i parë deri në tretin në Lojërat Mesdhetare”.
 - e. “Vendi i parë deri në të tretin në kampionate ballkanike”;
2. Në veprimtari kombëtare zyrtare:
 - a. “Anëtare të ekipit kombëtar M/F Seniores”
 - b. “Vendi i parë në kampionatin kombëtar”.
 - c. “Fitues i Kupës së Shqipërisë”

Neni 24

Trajneri

1. Shoqatat sportive, klubet sportive apo shoqëritë sportive, anëtare të FSHV duhet të punësojnë trajnerë të licensuar nga FSHV dhe të nënshkruajnë kontratë punësimi, në përputhje me Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë.
2. Shoqatat sportive, klubet sportive, shoqëritë sportive, nëpërmjet FSHV duhet të organizojnë kualifikime dhe trajnime për trajnere, sekretare, statisticien etj, për ngritjen profesionale të tyre.
3. Trajnerët duhet të vërtetojnë kualifikimet e tyre për kategorit përkatëse bazuar në rregullorën e brendeshme të FSHV.

Neni 25

Detyrimet e sportistit dhe trajnerit

1. Sportisti duhet të respektojë rregullat e FSHV dhe të Federatave Ndërkombëtare, parimet etike të sportit dhe të *fair-play*-t, kushtet e Konventës Ndërkombëtare të Antidopingut dhe rregulloret e veprimtarisë së aktiviteteve të FSHV.
2. Trajnerët dhe gjyqtarët respektojnë rregullat e *fair-play*-t, parimet e Kodit të Etikës, Konventën Ndërkombëtare të Antidopingut, si dhe rregulloret e FSHV.

KREU VI

INFRASTRUKTURA SPORTIVE

Neni 26

Ndërtimi dhe përdorimi i objekteve sportive

1. Objektet sportive të cilat do të përdoren për organizimet e aktiviteteve të FSHV duhet të plotësojnë kushtet e rregullave teknike, higjieno - shëndetësore në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregulloret e FSHV.
2. Standardet, kontrolli, mbikqyrja e objekteve sportive parashikohen në rregulloren mbi ndërtimin dhe përdorimin e këtyre objekteve sportive të përshtatshme për organizimin e aktiviteteve të FSHV sipas rregulloreve të brendeshme.

KREU VII

DREJTËSIA SPORTIVE

Neni 27

Shqyrtimi administrativ

1. FSHV krijon organet e gjykimit disiplinor, sipas procedurave të përcaktuara në rregulloret e miratuara nga Bordi Ekzekutiv.
2. Organet e gjykimit disiplinor të FSHV shqyrtojnë dhe vendosin masa ndëshkuese ndaj pjesëmarrësve në veprimtaritë, garat sportive, të paaautorizuara nga FSHV ose persona që kryejnë shkelje disiplinore, teknike, për prishjen e imazhit në kundërshtim me rregulloret e FSHV.
3. Vendimet e organeve të gjykimit disiplinor të FSHV mund të ankimohen në Këshillin e Arbitrazhit Sportiv (KAS) brenda 15-ditëve kalendarike nga shpallja e tyre.

Neni 28

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. FSHV pranon autoritetin e Këshillit të Arbitrazhit Sportiv.
2. Vendimet e organeve drejtuese të FSHV që bien në kundërshtim me ligjin dhe me këtë Statut, si dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve në fushën e sportit të volejbollit, ankimohen në Këshillin e Arbitrazhit Sportiv (KAS), organ i ngritur pranë Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar. Të gjitha organizatat sportive që aderojnë në FSHV dhe çdo sportist apo trajner i licensuar në sportin e volejbollit, kanë të drejtën e ankimit për vendimet e organeve drejtuese dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.
3. Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar, FSHV, klubet dhe shoqatat sportive, shoqëritë dhe çdo sportist apo trajner apo individ në sportin e volejbollit, pranojnë autoritetin e Këshillit të Arbitrazhit Sportiv (KAS). FSHV njeh dhe zbaton vendimet që merr Këshilli i Arbitrazhit Sportiv (KAS) për vete dhe për anëtarët e saj.
4. Vendimet e Këshillit të Arbitrazhit Sportiv (KAS) ankimohen vetëm në Gjykatën e Arbitrazhit të Sportit (CAS), në Lozanë të Zvicrës.

KREU VIII

ANTIDOPINGU, KONTROLI MJEKËSOR NË SPORT DHE SIGURIMI SHËNDETËSOR I SPORTISTËVE

Neni 29

Përdorimi i substancave dhe metodave doping

1. FSHV pranon autoritetin e Organizatës Kombëtare Antidoping për kontrollin e sportistëve, anëtarë të tyre, dënimin e përdoruesve të dopingut dhe substancave të ndaluara në procesin stërvitor, në veprimtaritë sportive zyrtare kombetare e nderkombetare të sportit të volejollit. Përdorimi i tyre është i ndaluar kategorikisht.
2. Lista e substancave e metodave doping të ndaluara në Republikën e Shqipërisë është e njëjtë me ato të miratuara nga Agjencia Botërore e Antidopingut.
3. Përdorimi i substancave dhe metodave doping, si dhe nxitja për përdorimin e tyre dënohen sipas normave ndërkombëtare, të pranuar nga FSHV.

Neni 30

Dispozita të veçanta në lidhje me dopingun

1. FSHV njih dhe merr përsipër të zbatojë sanksionet mbi Anti-dopingun dhe Feminitetin, konform rregullores së Federatës Ndërkombëtare.
2. FSHV njih autoritetin e Organizatës Kombëtare Antidoping në ushtrimin e kontrolleve antidoping me sportistët anëtarë të saj.
3. FSHV dhe të gjithë organizatat sportive anëtare të saj, pranojnë masat disiplinore dhe dënimet e dhëna nga Organizata Kombëtare Antidoping dhe Federata Ndërkombëtare për sportistët anëtarë të saj që rezultojnë pozitiv në këto kontrolle.
4. FSHV dhe Organizata Kombëtare Antidoping, si dhe të gjitha organizatat sportive të anëtare të saj janë të detyruara të respektojnë antidopingun sipas përcaktimeve të bëra në dispozitat e Konventës Ndërkombëtare Kundër Dopingut në Sport, 2005, të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 9623, datë 16.10.2006, "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare kundër Dopingut në Sport, 2005", dhe Konventës Europiane Antidoping të vitit 1989, të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 9242, datë 17.6.2004, "Për ratifikimin e Konventës Europiane Antidoping, 1989".

Neni 31

Kontrolli mjekësor në sport

1. Asnjë sportist nuk mund të licensohet nga FSHV dhe të marrë pjesë në veprimtaritë sportive të organizuara prej saj, pa paraqitur vërtetimin mjekësor që e lejon atë të ushtrojë sportin e volejbollit.
2. Sportistët, Trajnerët e Gjyqtarët e licensuar në FSHV për çdo sezon sportiv duhet të pajisen me kartelë mjekësore vetjake.
3. Kontrolli mjekësor i sportistëve bëhet nga vetë shoqatat, klubet, shoqëritë sportive etj, nga mjekë të licensuar, minimalisht një herë në sezon sportiv, për matjen e parametrave jetësorë.
4. Kontrolli mjekësor për të gjitha kategoritë e ekipeve kombëtare të FSHV bëhet nga struktura përgjegjëse e kontrollit mjekësor dhe rehabilitimit pranë Qendrës së Shërbimit të Sportit dhe Përgatitjes së Ekipeve Kombëtare.
5. Organizuesit e veprimtarisë sportive mbajnë përgjegjësi administrative për aktivizimin e sportistëve pa kartelë mjekësore në garat sportive

Neni 32

Sigurimi shëndetësor i sportistëve

1. Organizatat sportive, shoqatat sportive, klubet sportive, shoqëritë sportive, anëtare të FSHV, janë përgjegjëse për sigurimin shëndetësor të sportistëve që marrin pjesë në veprimtaritë zyrtare sportive që organizohen prej tyre.
2. Sigurimi shëndetësor i sportistëve përballon të gjitha shpenzimet për mjekimin e dëmtimeve që mund t'u ndodhin sportistëve gjatë veprimtarisë së tyre sportive.
3. Organizata sportive, shoqatat sportive, klubet, shoqëritë sportive, anëtare të FSHV, që lejojnë pjesëmarrjen në veprimtaritë sportive të sportistëve të pasiguruar nga ana shëndetësore, detyrohet të paguajë të gjitha shpenzimet për rehabilitimin e sportistit në raste dëmtimi në veprimtarinë sportive, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.
4. FSHV është përgjegjëse për sigurimin shëndetësor të sportistëve të ekipeve kombëtare gjatë grumbullimeve stërvitore dhe pjesëmarrjes në veprimtaritë ndërkombëtare.

KREU IX
PARANDALIMI I DHUNËS NË SPORT

Neni 33

Ndalimi i provokimeve dhe i sjelljeve të palejuara

1. Gjatë veprimtarive sportive të të gjitha niveleve ose gjatë transmetimit të tyre në publik ose në mjedise ku ato zhvillohen, ndalohet provokimi ose përpjekja për provokim me karakter politik, shoqëror, racial, fetar a gjinor, që synon nxitjen e urrejtjes e të dhunës ndaj pjesëmarrësve në veprimtarinë sportive dhe/ose ndaj spektatorëve.
2. Gjatë veprimtarive sportive të të gjitha niveleve ose gjatë transmetimit të tyre në publik ose në mjedise ku ato zhvillohen, ndalohen sjelljet e palejuara të mëposhtme:
 - a. Sulmi fizik ndaj çdo pjesëmarrësi në ngjarjen sportive, qofshin pjesëmarrës të drejtpërdrejtë të veprimtarive sportive apo shikues, ose përleshja fizike mes pjesëmarrësve dhe tifozëve;
 - b. Gjuajtja e sendeve në terrenin sportiv të lojës ose në tribunat e tifozëve;
 - c. Shfaqja e materialeve propaganduese, me të cilat fyhen ndjenjat kombëtare ose ndjenjat e tjera ose kryejnë provokim me karakter politik, shoqëror, racial, fetar a gjinor;
 - d. Ndërmarrja e veprimeve që nxisin urrejtje e që mund të sjellin deri në dhunë apo sulme fizike;
 - e. Dëmtimi i mjediseve të sportit, pajisjeve sportive, instalimeve dhe pajisjeve të tjera në mjedisin sportiv;
 - f. Veprimet me të cilat pengohet hyrja apo dalja e pjesëmarrësve në mjedisin sportiv, pengimi i zhvillimit të veprimtarisë sportive apo shkaktimi i pasigurisë në mjedisin sportiv për pjesëmarrësit apo personat e tjerë;
 - g. Hyrja e paautorizuar në hapësirat e mjedisit sportiv dhe të terrenit sportiv;
 - h. Hyrja e paautorizuar në hapësirat zyrtare dhe në kalimet zyrtare të mjedisit sportiv ose në pjesën e tribunës që i caktohet tifozëve të ekipit mik;
 - i. Djegia e rekuizitave, shenjave identifikuese të shteteve, klubeve etj., ose e sendeve të tjera në mjedisin sportiv;
 - j. Përdorimi i maskave ose sendeve të tjera, me qëllim fshehjen e identitetit ose fshehjen e fytyrës;
 - k. Trukimi i rezultateve të veprimtarive sportive.

3. Organizatori i veprimtarisë sportive është i detyruar të ndërmarrë të gjitha masat dhe veprimet e nevojshme për sigurimin e veprimtarisë sportive dhe, në veçanti, të kujdeset për marrjen e masave parandaluese të shfaqjes së provokimeve e të sjelljeve të tjera të palejuara.
4. FSHV me anë të Komisionit të Disiplinës, në veprimtarinë kundër dhunës në Shqipëri, respektojnë dispozitat e Konventës Europiane Kundër Dhunës në Sport ku aderohet Republika e Shqipërisë.

Neni 34

Sendet e palejuara në objektet dhe mjediset sportive

1. Ndalohen mbajtja dhe përdorimi në objektet e mjediset sportive dhe gjatë zhvillimit të veprimtarive i fishekzjarrëve, flakadanëve, lëndëve piroteknike dhe sendeve të tjera të forta, të rrezikshme për jetën dhe shëndetin e pjesëmarrësve, i armëve të të gjitha llojeve, si edhe përdorimi e tregtimi i pijeve alkoolike.
2. Gjatë veprimtarive sportive personat në cilësinë e përfaqësuesit të FSHV, gjyqtarëve dhe vëzhguesve, janë të paprekshëm.

Neni 35

Ruajtja e rendit dhe e sigurisë publike

1. Organizatori i një veprimtarie sportive është i detyruar të njoftojë Policinë e Shtetit me shkrim të paktën 7-ditë kalendrike përpara zhvillimit të saj, me qëllim planifikimin e të gjitha masave të nevojshme të sigurisë për mbarrëvajtjen e saj.
2. Në këtë njoftim, organizatorët duhet të përcaktojnë edhe shërbimin privat të sigurisë fizike (SHPSF) të kontraktuar për marrjen e masave të sigurisë në mjediset sportive.
3. Ruajtja e rendit dhe e sigurisë publike në mjediset sportive është detyrë institucionale e organeve të Policisë së Shtetit.
4. Administratorët e objekteve dhe mjediseve sportive, në bashkëpunim me klubet sportive, nëpërmjet shoqërive private të sigurisë fizike (SHPSF), duhet të marrin këto masa:
 - a. Të kryejnë kontrollin rigoroz të tifozëve në portat e hyrjeve në mjedisin sportiv;
 - b. Të kryejnë sigurimin e vendkalimeve publike në mjedisin sportiv;
 - c. Të kryejnë drejtimin e spektatorëve tek ulëset në mjedisin sportiv dhe mbajtjen e tyre nën kontroll;

- d. Të kryejnë sigurimin dhe mbrojtjen e lojtarëve nga futja e tifozëve në mjedisin sportiv.
- 3. Administratorët e mjediseve sportive marrin masat për caktimin e një ambienti të përshtatshëm për drejtuesit e njësisë policore për monitorimin e situatës së rendit publik në mjedisin sportiv.

Neni 36

Roli i oficerit të sigurisë në veprimtaritë ndërkombëtare

- 1. Në veprimtaritë ndërkombëtare të organizuara nga FSHV brenda dhe jashtë vendit, duhet të marren masa për sigurinë e ekipeve kombëtare nëpërmjet kontaktimit të oficerit të sigurisë.
- 2. Oficeri i sigurisë duhet:
 - a. Të ketë qenë në nivelin drejtues në Policinë e Shtetit;
 - b. Të ketë përvojë në organizimin dhe menaxhimin e masave të sigurisë gjatë veprimtarive sportive;
 - c. Të ketë gatishmërinë për të punuar me autoritetet publike dhe të Policisë së Shtetit.
- 3. Oficeri i sigurisë mban kontakte me autoritetet policore, shërbimet e urgjencës dhe përfaqësuesit e tifozëve. Ai është përgjegjës për vlerësimin dhe raportimin tek organizatori i veprimtarisë sportive, duke marrë masa që ato të mos ndikojnë në sigurinë e veprimtarisë.
- 4. Oficeri i sigurisë është përgjegjës për vlerësimin e adresimin e rreziqeve dhe për marrjen e masave në koordinim me policinë, shërbimet e emergjencës, autoritetet publike dhe çdo subjekt tjetër të përfshirë në menaxhimin e ngjarjes.

KREU X

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 37

Dispozita te fundit

1. Për çështjet që nuk parashikohen në këtë Statut ose për çështje të forcave madhore do të zgjidhen duke ju referuar dispozitave të Ligjit Nr.97/2017, datë 27.04.2017 “Për Sportin”i ndryshuar, Kodit Civil, ligjit Nr. 8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat Jofitimprurëse” të ndryshuar, ligjit Nr. 8789, datë 07.05.2001 “Për regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse” të ndryshuar, si dhe akte të tjera ligjore e nënligjore që rregullojnë këtë aktivitet.
2. Çdo ndryshim i Statutit të FSHV, do të degjohet për miratim në Asamblen e Përgjithshme të FSHV.

Neni 38

Hyrja në fuqi

Ky Statut i FSHV hyn në fuqi pas vendimit të gjykatës së rrethit gjyqësor, Tiranë.

Nga anëtarët e Asamblesë së Përgjithshme të Federatës Shqiptare te Volejbollit.

Më *datë 19.09.2025* .

Nënshkruar nga përfaqësuesi i Autorizuar

Presidenti i FSHV

Erlind Pëllumbi

Sekretari i Përgjithshëm

Ervis Dosti